



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primjencë Më/Dana <u>29-05-2015</u> V.God.			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Tjera Vrednosit
<u>01-013/746</u>			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Vitia

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenit 36.1 dhe 36.2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 28.05.2015, aprovon këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR PRONAËN E PALUAJTSHME TË KOMUNËS KOMPANISË KKDFE SH.A 'KEDS' J.S.C. PËR VENDOSJEN E NJË TRAFU ELEKTRIKE

Neni 1.

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë APROVON Vendimin për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite pronën e paluajtshme të Komunës së Vitisë, Kompanisë KKDFE Sh.a "KEDS" J.S.C. njësia në Viti për vendosjen e një trafo elektrike në parcelën me numër 2016-2 me sipërfaqe prej 4m², në Zonën Kadsatrale në Smirë.

Neni 2.

Parcela kadastrale e sipër shënuar që është objekt i këtij vendimi i jepen në shfrytëzim afatshkurtër pa të drejtën e dhënies me qira, pa të drejtën e nën kontraktimit me personat e tretë, me mundësi të vazhdimit vetëm për destinacionin e përcaktuar më lartë dhe nuk mund të shfrytëzohen për qëllime tjera.

Neni 3.

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë obligohet të caktoj taksën ndaj kompanisë së lartcekur bazuar në Rregulloren komunale për taksa ngarkesa dhe gjoba me numër 01-013/1356 të datës 30.09.2014.

Neni 4.

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset: Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe Zyra e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

Neni 5.

Ky Vendim, hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi i dorëzohet:

1. Drejtorisë për Kadastër,
2. Zyrës së Kryetarit,
3. Drejtorisë për Shërbime Publike
4. Shërbimit të kuvendit
5. Arkivit

